



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 gusht 2021

Nr. ref.:RK 1833/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI25/21

Parashtrues

Ymer Koro

si përfaqësues i pretenduar i personave K.Lj. dhe K.B.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme XXX të
2 tetorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ymer Koro, avokat nga Prizreni, i cili pretendon se është përfaqësues i personave K.Lj. dhe K.B. (në tekstin e mëtejme: përfaqësuesi i pretenduar).

Vendimi i kontestuar

2. Përfaqësuesi i pretenduar e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme XXX të 2 tetorit 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se personave K.Lj. dhe K.B. u janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 shkurt 2021, përfaqësuesi i pretenduar e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 5 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi Gjyqtare raportuese dhe Kolejin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 9 shkurt 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e pretenduar për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të plotësojë kërkesën me informata shtesë, më saktësisht të dorëzojë në Gjykatë autorizimin me të cilin është autorizuar nga personat K.Lj. dhe K.B. për t'i përfaqësuar ata para kësaj Gjykate.
8. Më 23 shkurt 2021, Gjykata e pranoi shkresën e përfaqësuesit të pretenduar ku ai kërkoi zgjatjen e afatit për dorëzimin e autorizimit, duke arsyetuar se këto raste janë raste specifike dhe vetvetiu kërkojnë një afat më të gjatë kohor për të siguruar autorizimin.
9. Më 4 mars 2021, Gjykata i dërgoi një shkresë përfaqësuesit të pretenduar në të cilën e miratoi zgjatjen e afatit për dorëzimin e autorizimit për përfaqësimin e personave K.Lj. dhe K.B. në Gjykatë.
10. Përfaqësuesi i pretenduar e pranoi shkresën e Gjykatës më 8 mars 2021, dhe këtë fakt Gjykata e vërtetoi në bazë të dëshmisë për dorëzimin e shkresës.

11. Përfaqësuesi i pretenduar nuk e dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësimin e personave K.Lj. dhe K.B., në emër të të cilëve, siç pretendon, e paraqiti kërkesën në Gjykatë.
12. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.
13. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës nr. KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
14. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani nxori vendimin nr. KSH. KI25/21, duke zëvendësuar anëtarin e mëparshme të Kolegjit shqyrtues Arta Rama-Hajrizi, në rolin e saj si anëtare e Kolegjit shqyrtues, me gjyqtaren Gresa Caka-Nimani.
15. Më 21 korrik 2021, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën.

Përmbledhja e fakteve

16. Gjykata nuk i referohet fakteve të këtij rasti, pasi që kërkesa është parashtruar nga një përfaqësues i pretenduar i cili nuk ka dëshmuar të ketë autorizimin për të parashtruar këtë kërkesë në emër të personave K.Lj. dhe K.B. Prandaj, Gjykata as nuk do të deklarojë në vendim numrin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme, të cilin pretendohet se ai konteston në emër të personave K.Lj dhe K.B.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Gjykata gjithashtu nuk i referohet as pretendimeve të cilat pretendohet se përbëjnë pretendime dhe pohime që i përkasin personave K.Lj. dhe K.B., pasi që kërkesa është dorëzuar nga përfaqësuesi i pretenduar pa një autorizim të vlefshëm.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata fillimisht vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të përcaktuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

20. Gjykata i referohet edhe nenit 21 [Përfaqësimi] të Ligjit, i cili përcakton:

“Palët gjatë procesit para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohen vet ose nga një përfaqësues i autorizuar nga pala.”

21. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

[...]

“(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor;

[...].

(3) Nëse pala ka përfaqësues, përfaqësuesi dorëzon në Gjykatë bashkë me kërkesë, autorizim të vlefshëm.”

22. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, Gjykata vërejti se ekziston një prokurë e përgjithshme, përmes së cilës personat K.Lj. dhe K.B., më 11 shkurt 2010, e autorizuan personin E.O. nga Prizreni, për të kryer disa veprime administrative në kadastrë në mënyrë që t'i sigurojë dokumente të caktuara në lidhje me ngastrat kadastrale në fjalë, për të dorëzuar dhe siguruar pranë shërbimit kompetent komunal, dokumente personale për personat K.Lj. dhe K.B. si dhe dokumente për paraardhësit e tyre ligjor, për të paraqitur padinë në gjykatën kompetente për çështjen e anulimit të një aktvendimi të caktuar, si dhe mundësinë e ushtrimit të mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike në lidhje me vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë.
23. Gjykata gjithashtu vërejti se personi E.O. nga Prizreni, me këtë prokurë të përgjithshme ishte i autorizuar për t'i bartur të gjitha autorizimet nga prokura mbi personat e tretë.
24. Gjykata më tej konstaton se në të njëjtën ditë kur personat K.Lj. dhe K.B. ia dhënë prokurën e tyre të përgjithshme personit E.O., ai e barti prokurën mbi personin M.P. nga Prizreni.

25. Më tej, Gjykata vëren se më 23 dhjetor 2012, personi M.P. nga Prizreni e barti prokurën për përfaqësimin e personave K.Lj. dhe K.B. mbi personin i cili paraqitet këtu para Gjykatës në cilësinë e përfaqësuesit të pretenduar.
26. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh se nga koha kur prokura e përgjithshme e personave K.Lj. dhe K.B. iu dha personit E.O. kanë kaluar shumë vite, si dhe vetë faktin se autorizimet nga prokura janë bartur mbi një numër më të madh të personave, Gjykata, më 9 shkurt 2021, i dërgoi një shkresë përfaqësuesit të pretenduar duke kërkuar *“që përfaqësuesi i pretenduar të plotësojë kërkesën me informata shtesë, më saktësisht të dorëzojë në Gjykatë autorizimin me të cilin personat K.Lj. dhe K.B., e autorizuan atë që t'i përfaqësojë ata para kësaj Gjykate”*.
27. Gjykata rikujton se më 23 shkurt 2021, Gjykata e pranoi shkresën e përfaqësuesit të pretenduar në të cilën kërkoj që Gjykata të zgjaste afatin kohor për sigurimin e autorizimit për përfaqësimin e personave K.Lj. dhe K.B.
28. Më 4 mars 2021, Gjykata i dërgoi përfaqësuesit të pretenduar një shkresë në të cilën e miratoi afatin për sigurimin dhe dorëzimin e autorizimit për përfaqësimin e personave K.Lj. dhe K.B. Shkresa e Gjykatës e 4 marsit 2021, është pranuar nga përfaqësuesi i pretenduar më 8 mars 2021, dhe këtë fakt Gjykata e vërtetoi në bazë të dëshmisë për dorëzimin e shkresës.
29. Gjykata në veçanti thekson faktin se përfaqësuesi i pretenduar deri me dorëzimin e këtij raporti te Kolegji shqyrtues, nuk e dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësimin e personave K.Lj. dhe K.B.
30. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata më tej i referohet rregullit 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“[...] (5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze. [...].”
31. Gjykata konsideron se përfaqësuesi i pretenduar nuk ofroi informata që Gjykata u përpoq t'i merrte nga përfaqësuesi i pretenduar përkundër faktit se ajo kishte miratuar kërkesën e tij për zgjatjen e afatit për dorëzimin e autorizimit. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është e paplotë (shih Vendimin për refuzimin e kërkesës në rastin KI16/18, të 31 dhjetorit 2018, si dhe Vendimin për refuzimin e kërkesës në rastin KI23/18, të 4 shkurtit 2019).
32. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 21 korrik 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka Nimani